



Prishtinë, 15 qershor 2015
Kodi i ZRRE-së: V_735_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 14 paragrafi 6 dhe 7 i Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja (në fuqi nga data 11.11.2014);
- Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_537_2013 i datës 28 qershor 2013; dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bistrica, HC Albaniku 2, me kapacitet të instaluar prej 9.85 MW, në lokacionin "Batahir", ZK Batahir, komuna e Mitrovicës, të datës 26.05.2015 të ndërmarrjes "Hydro - Line" SH.P.K., me adresë "Mbretëresha Teutë", p.n. -Mitrovicë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 15 qershor 2015 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_537_2013 i datës 28 qershor 2013, edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht deri me **28 dhjetor 2015**.

A r s y e t i m

- o ZRRE, me datë 03.05.2013 nga shoqëria "Hydro - Line" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bistrica, HC Albaniku 2, me kapacitet të instaluar prej 9.85 MW, në lokacionin "Batahir", ZK Batahir, komuna e Mitrovicës.
- o ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, me datë 28 qershor 2013 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_537_2013, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- o Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- o Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (2) dy vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqërisë "Hydro - Line" SH.P.K., do t'i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- o ZRRE me datë 26.04.2015 nga shoqëria "Hydro - Line" SH.P.K., ka pranuar Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për



ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në në Lumin Bistrica, HC Albaniku 2, me kapacitet të instaluar prej 9.85 MW, në lokacionin "Batahir", ZK Batahir, komuna e Mitrovicës, edhe për një afat shtesë sipas legjislacionit në fuqi.

- Shoqëria "Hydro - Line" SH.P.K., në kërkesë e saj ka sqaruar se: "Janë në proces të përfundimit të projektit të zbatimit dhe vonesat kanë ardhur si pasojë e projektimit dhe procedurave të shpronësimit të pronave private që interferojnë në realizimin e projekteve dhe si rrjedhojë ka ngecur edhe projektimi i saktë i HC Albaniku 1. Ka theksuar se nga rrethanat e cekura janë krijuar dhe kanë ardhur deri te vonesat që kanë dalur gjatë realizimit të projektit sa më të saktë".
- ZRRE pas analizimit të kërkesës dhe vlerësimit të rëndësishëm të projekti i tillë, ka vlerësuar kërkesës për shtyerje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

V. Shoqëria "Hydro - Line" SH.P.K., obligohet që të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bistrica, HC Albaniku 2, me kapacitet të instaluar prej 9.85 MW, në lokacionin "Batahir", ZK Batahir, komuna e Mitrovicës, deri me datën **28 dhjetor 2015** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.


VI. Pas skadimit të afatit të cekur më lartë, Vendimi V_537_2013 i datës 28 qershor 2013 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.


VII. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.


VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Kreinar Bujupi, anëtar.